

# Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

## 1. Hyrje

Ujesjelles Kanalizime Shkoder Sh.a. ("Shoqëria") është regjistruar si shoqëri në Shqipëri, bazuar në Vendimin e Gjykatës Nr. 24712/0, datë 23 nëntor 2000 i cili ka miratuar aktin e ekspertit kontabel për vlerësimin e kapitalit për transferimin e Ndermarrjes Shtetërore Ujesjellesi Shkoder në Shoqëri Anonime.

Aksionari i vetëm është Bashkia Shkoder me pronesi të plote prej 100 % të aksioneve.

Aktiviteti i shoqërisë është: Sherbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirembajtjen e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura. Mirembajtja e sistemeve të urjave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Licensat që zoteron "Shoqëria":

- Licensa: Leje Mjedisore me Nr. **PN-7730-08-2014**.

Administrator i shoqërisë është Z. Mark Molla.

- Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Lagjja Tre Heronjte, Rruga Marin Biçikemi, zona kadastrale 8593 e numer pasurie 5/250, Shkoder.
- Adresa të tjera të ndryshimit të aktivitetit:
- Shkoder GURI I ZI GURI I ZI Guri i Zi, Rruga Nacionale
- Shkoder Mjede, Lagjja Bicaj, ndertese 1-kateshe, nr.4
- Shkoder Dajc DAJC Dajc, Lagjja Bregu i Bunes, Rruga Qender, ndertese 2-kateshe, nr.7
- Shkoder Ana Malit OBLIKE Oblike, Lagjja Oblike, Rruga Qender, ndertese 1-kateshe, nr.5
- Shkoder Rrethina RRETHINAT Rrethinat, Lagjja Stom Golem, Rruga Qender, ndertese 1-kateshe, nr.3
- Shkoder Berdice BERDICE Berdice, Lagjja Berdice e Siperme, Rruga Qender, tek rrethrotullimi, ndertese 1- kateshe, nr.2
- Shkoder POSTRIBE POSTRIBE Postribe, Lagjja Qender Mes, Rruga Postribe, ndertese 1-kateshe, nr.1
- Shkoder Shkoder SHKODER Lagjja Tre Heronjte, Rruga Tre Heronjte, zona kadastrale 8593 e numer pasurie 7/24
- Shkoder Velipoje VELIPOJE Velipoje, Lagjja Gomsiqe e Re, Rruga Qender, ndertese 2-kateshe, nr.6

## 2. Bazat e përgatitjes

### (a) Deklarata e pajtueshmërisë me parimet kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

### (b) Baza e përgatitjes financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### (c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes së pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### (d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime, vlerësime dhe supozime nga ana e Drejtimit të Shoqërisë, të cilat mund të ndikojnë aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet kontabël janë njohur për periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe për periudhat e ardhme të ndikuara.

## 3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Politikat kontabël të pasqyruara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

### 3.1 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar apo zhvlerësimin dhe rivlerësimin.

## 3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

### 3.1 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)





# Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribuueshme për sjelljen e aktivit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

## (ii) Kostot e zëvendësimit

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot që rrjedhin nga përdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

## (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve llogaritur në bazë të metodës së vlerës së mbetur. Normat vjetore të aplikuar të amortizimit janë si më poshtë:

• Truall	0 %
• Ndertese	5 %
• Mobilje dhe pajisje	20%
• Pajisje informatike	25%

### 3.2 Aktivët afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria, të cilat përfshijnë programe kompjuterike (software), janë regjistruar me kosto të pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin (në rastin kur aplikohet). Amortizimi llogaritet në bazë të metodës së kostos historike dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Norma vjetore e aplikuar e amortizimit është 15%.

### 3.3 Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo derivative të përbëra nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo derivative njihen fillimisht me vlerë të drejtë, plus, për instrumentet të njohura jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot direkte të atribuueshme.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e një provizionimi kontraktual mbi instrumentin. Instrumentet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukse monetare përfundojnë ose Shoqëria transferon aktivin financiar të një palë tjetër pa mbajtur më kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit të tyre, që do të thotë në datën kur Shoqëria angazhohet për të blerë apo shitur aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë përfundojnë apo anulohen.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare joderivative maten si më poshtë.

#### Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat Shoqëria i përdor për manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar. Mjetet në valute të huaja janë konvertuar me kursin e dates së raportimit.

#### Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe vlerësuar më pas me kosto të amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

#### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

### 3.4 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivët financiare





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ekzistojnë tregues objektivë që një ose më shumë ngjarje mund të kenë ndikim negativ në flukset e pritshme të ardhme që do të gjenerojë ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuara llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhme të skontuara me normën e interesit efektiv origjinal.

Aktivitetet financiare individuale me vlerë të konsiderueshme testohen për zhvlerësim individual. Pjesa tjetër e aktiveve financiare grupohen në grupe me karakteristika rreziku të njëjta. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitime ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi fillestar. Rimarrja njihet në fitime ose humbje.

### (ii) Aktivitetet jofinanciare

Vlera e mbartur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë është rishikuar në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit riveksetohet. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit tejkalon atë të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në humbje ose fitim.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parave tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron flukse monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivitetet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim flukset e pritshme të parasë skontohen deri në vlerën aktuale të tyre duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton kushtet e vlerësuarat të tregut dhe vlerën në kohë të parasë si dhe rreziqet specifike që lidhen me këtë aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm nëse vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

### 3.5 Përfitimet e punonjësve

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjisllacionit vendas. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

### 3.6 Të ardhurat

Të ardhurat e fituara gjatë aktivitetit të zakonshëm maten me vlerën e drejtë të kompensimit të pranuar ose të arkëtueshëm, neto nga zbritjet. Të ardhurat njihen atëherë kur rreziqet dhe përfitimet e konsiderueshme lidhur me shitjen transferohen tek blerësi, kur arkëtimi është i mundshëm, kur kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen dhe kur e ardhura matet me besueshmëri.

Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimëve varion në varësi të kushteve individuale të kontratave të shitjes së ujit.

### 3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat (shpenzimet) financiare neto përbëhen nga shpenzimet e interesit, dhe nga fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara nga këmbimet valutore, të cilat raportohen neto në këto pasqyra financiare.

### 3.8 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në datën e raportimit me normën e këmbimit të kësaj date.

Monedha	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2018
	LEKE/valute	LEKE/valute	LEKE/valute
USD	100.84	108.64	107.82
EUR	123.7	121.77	123.42

## 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kreditimit





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit nga rreziqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe manaxhimin rrezikut dhe mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shënime të tilla sasiore janë të përfshira gjatë gjithë pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë për hartimin e procedurave për manaxhimin e rreziqeve të Shoqërisë.

Politikat e manaxhimit të rrezikut janë krijuar nga Shoqëria për të analizuar dhe identifikuar rreziqet me të cilat Shoqëria përballëet dhe për të përcaktuar metodat e kontrollit dhe caktimin e limiteve sipas të cilave do të monitorohen treguesit e rreziqeve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rreziqeve janë riparë rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe të aktiviteteve të Shoqërisë.

Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare në bankë, llogari të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera.

### **(i) Rreziku i kreditimit**

Ekziston një rrezik kreditimi në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura, për të cilat nuk është regjistruar zhvlerësim, të një cilësie të kënaqshme.

### **(ii) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në kohën e maturimit të tyre. Përqasja e Shoqërisë është të sigurojë sa më tepër likuiditete të jetë e mundur që të ketë kurdoherë fonde të mjaftueshme likuide për të përmbushur detyrimet e saj brenda afateve normale apo të forcuara, pa shkaktuar humbje të papranueshme apo rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

### **(iii) Rreziku i tregut**

Rreziku i kurseve të këmbimit

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë dhe në Euro. Rreziku i monedhës kryesisht manaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së të drejtave dhe detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëdhënie mbrojtëse apo për produkte derivative më 31 dhjetor 2020 (2019: asnjë).



A handwritten signature in blue ink, located to the right of the stamp.



# Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

## Analiza e posteve te bilancit

### 1. AKTIVET AFATGJATA

Aktivët afatgjatë perbehen nga :

Aktive afatgjata materiale	1	2,491,663,593
Aktive afatgjata materiale per investim	2	2,456,352,839
Aktive te tjera afatgjata jo-materiale	3	89,959,456
		<b>5,037,975,888</b>

Emertimi	Truall	Ndertim Instalime pergjithshme	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Totali
Gjendje 31.12.2019	<b>362,818,085</b>	<b>1,468,957,170</b>	<b>259,247,854</b>	<b>64,986,267</b>	<b>8,234,131</b>	<b>2,164,243,507</b>
<b>Rivleresimi</b>	(1,269,641)	361,022,132	121,418,814	-	-	481,171,304
Gjendje 31.12.2019	<b>361,548,444</b>	<b>1,829,979,302</b>	<b>380,666,668</b>	<b>64,986,267</b>	<b>8,234,131</b>	<b>2,645,414,812</b>
<b>Shtesa</b>	-	19,508,332	7,278,795	1,240,000	1,476,000	29,503,127
<b>Pakesime</b>	-	-	(31,350)	-	(306,883)	(338,233)
<b>Amortizimi</b>	-	(91,528,774)	(76,228,217)	(13,100,587)	(2,058,533)	(182,916,111)
Gjendje 31.12.2020	<b>361,548,444</b>	<b>1,757,958,860</b>	<b>311,685,895</b>	<b>53,125,680</b>	<b>7,344,715</b>	<b>2,491,663,594</b>

### 5. Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme.

Detajime Kliente	
<b>Kliente Abonente institucione</b>	15,308,804.19
<b>Kliente Abonente Biznes</b>	126,177,100.46
<b>Kliente Abonente Familjare</b>	957,324,908.12
<b>Kliente Sherbime te Tjera</b>	1,904,747.69
<b>Kliente per Taksa Bashkia Shkoder</b>	533,478,752.32
	<b>1,634,194,313</b>

### 6. Llogari te tjera te arketueshme tregtare

### 7. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Llogaria	31/12/2020
<b>Banka</b>	103,243,359.85
<b>Totali</b>	<b>103,243,359.85</b>

### GJENDJE BANKA

KODI	Liste bankash	Vlera ne monedhe te huaj	Monedha e huaj	Kursi	Vlera ne Lek
<b>B01.</b>	ProCredit, (TA - 00)				124,052.21
<b>B02.</b>	ProCredit, (Paga - 01)				903.48
<b>B03.</b>	Raiffeisen Bank				1,045,792.55
<b>B04.</b>	BKT (Bank Komb. Treg)				31,166,684.47
<b>B05.</b>	Tirana Bank (TA - 100)				244,739.42
<b>B06.</b>	Intesa San Paolo				325,821.25
<b>B07.</b>	Credins bank				12,700,341.55
<b>B08.</b>	ABI Bank - ish NBG bank				-7,645.89
<b>B09.</b>	Soci. Gener. Alb				497,066.93



*[Handwritten signature]*



## Shënjës Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

B10.	UBA (Un.Bank.Alb)			70,028.86
B11.	Union Bank (TA - 114)			17,789,907.39
B12.	ABI Bank -ish NBG (paga)			6,600.00
B16.	Tirana Bank (paga - 101)			4,973,672.52
B17.	First Invst bank			110,162.52
B19.	Union bank (Paga - 216)			819,266.88
B20.	Banka e Thesarit SHKODER			27,233,656.00
B22.	Credit Agricole ABI			7,000.00
B14.EUR	BKT Euro	49,598.30	€	123.7
				<b>Total 103,243,359.85</b>

Gjendja e bankave është konfirmuar me konfermat bankare që janë të rakorduara me ditarin dhe bilancin.

### 8 . Disponibilitete ne thesar

#### DISPONIBILITETE NE THESAR / NE UDHETIM

5202	Disponibilitete ne udhetim ( arketimet e dt 31.12.2020 )			1,428,906.39
5203	Disponibilitete ne udhetim ( arketimet nga operatorët bashkepunues )			1,190,426.06
5204	Disponibilitete ne thesar per 5 % garanci per Sit. Alb Kons			429,252.00
5205	Disponibilitete ne thesar per 5 % garanci per Sit. Alb Kons			610,407.00
				<b>3,658,991.45</b>

### KAPITALI

#### i. Gjendja dhe ndryshimi i kapitalit

Kapitale e veta:				
	Kapitali aksionar			863,468,000
	Rezerva rivleresimi			738,954,521
	Rezerva ligjore			2,562,800
	Fitimi i akumuluar			22,039,403
	Fitimi i vitit			288,915
				<b>1,627,313,640</b>

### 14. Te ardhura te shyra Grante

1331	Grande nga Projektet			3,809,399,220.00
1332	Grande per AAM			121,279,895.14
1333	Grande te pa financuara			2,432,123.00
				<b>3,933,111,238</b>

### 15. Detyrim tatim fitimi Viti Aktual (llogaritja)

NR	EMERTIMI	VLERA
I	Rezultati ushtrimor	8,735,437
II	Shpenzime te panjohura	47,574,707
	Gjoha dhe demshperblime	1,051,285
	Shpenzime gjyqesore	2,338,762
	Provizion per ceshtje gjyqesore ne proces	1,511,558
	Amortizim I Aqt te rivleresuara ( I pazbritshem fiskal)	42,334,869
	Shpenzimet tjera ( Humbjet nga rivlersimi i aktiveve)	338,233
III	Fitim/( Humbja) Fiskale	56,310,144
	Tatim fitimi 15 %	8,446,522





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

### 16. Provizione

PROVIZIONE		
491	Provizione per faturat e klienteve mbartura	299,614,353.00
497	Provizion per ceshnje gjyqesore	1,511,558.00
4960	PRIVIZION PER TVSH E FALUR SIPAS LIGJIT mbartur	31,770,547.46
		<b>332,896,458</b>

### 17. Detyrime ndaj personelit dhe sigurimeve

Detyrimi per pagat , sigurimet shoqerore e shendetsore, tap jane detyrime qe i perkasin muajit Dhjetor 2020 .

### 18. Te ardhurat

Të ardhura	20	290,444,277
Të ardhura te tjera nga aktiviteti I shfrytezimit	21	364,564,365
		<b>637,008,642</b>


### Te ardhura sipas FDP

LLOJI I SHERBIMIT TE OFRUAR		
704101	Tarife Fikse	38,794,850.00
704102	Konsum Uji i Pijshem	191,326,122.23
704103	KUZ (Ujera te Perdorura)	50,937,333.90
704201	Azhornim rrjeti	692,500.27
704202	Pike Lidhje ne rrjet	837,500.02
7043	Te ardhura nga pun. tj. (Qera ambiente)	1,867,698.00
7046	TA Pastrim gropa septike (jo ne sistem)	329,166.78
70471	TA vendosje Sahati Qytet	1,423,434.49
70472	TA vendosje Sahati Fshat	1,136,283.04
70481	TA Hapje kontrate Qytet	635,000.56
70482	TA Hapje kontrate Fshat	271,672.10
70483	TA # emri Kontrate Qytet	149,250.00
70485	TA Pezullim Kontrate Qytet	150,000.12
70487	TA Mbyllje Kontrate Qytet	62,500.12
70488	TA Mbyllje Kontrate Fshat	21,667.10
70491	TA Shitja e Librezave Qytet	143,964.72
70492	TA Shitja e Librezave Fshat	23,638.04
70493	TA Vertetim Qytet	12,001.02
70495	TA Gjoba Kundravenje Qytet	1,240,000.00
70496	TA Gjoba Kundravenje Fshat	200,000.00
7088	Te tjera	189,694.28
		<b>290,444,276.79</b>

Te ardhura te tjera ne vleren 346,564,365 perbehen nga TA nga kamatat e arketuara , nga subvencionet e ndryshme nga Bashkia dhe Ministria e Financace , per mbulimin e shpenzimeve operative te Shoqerise etj.

### Shpenzimet

<b>22. Materiale te konsumueshme , blerje energjie</b>	
Blerje Energji	133,052,510.30
Blerje materiale te konsumueshme	17,449,708
Blerje uje	82,900
	<b>150,585,119</b>
<b>23. Shpenzime personeli</b>	
Paga	145,681,822.00
Sigurime	24,348,331.00
	<b>170,030,153.00</b>
<b>24. Amortizimi dhe zhvleresimi</b>	
	<b>263,199,823</b>
<b>25. Shpenzime të tjera operative</b>	
Shpenzime Roje Private	19,619,112





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

Shpenzime Ekspertet kontabel	2,100,000
Trajnime+pjesmarrje ne konference (shukalb)	1,018,600
Printim fatura e UK	2,457,837
Qera automjete	3,456,000
Riparim makina (oficina)	90,000
Sistemi i dep finances (fin5)	5,000
Sistemi i dep shitjes (3S)	40,314
Sistemi i ëeb page	24,302
Sistemi i Gis hartografia	480,000
Avolzhim, Riparim, sherbim elektromotori	204,000
Riparime te tjera	1,042,775
Sigurime	501,930
Studime dhe kerkime	1,173,848
Te tjera	422,317
Paga, honorare(Keshilli Mbikeqyres)	2,335,000
Shpenz, patenta, licensa taksa	409,640
shpenzim kolaudime	36,051
Sherbim GPS per automjete	352,084
Shpenzim postar	26,250
Shpenzim interneti	366,219
Sherbime bankare	213,927
shpenzim raste vdekje personeli	50,000
Gjoha dhe demshperblime	1,051,285
Pagesa rregullatore (ERRU)	1,675,100
Kuota e rregjistrimit (Basenet ujore)	1,189,792
Shpenzime gjyqesore	2,338,762
Provizion per çeshtje gjyqesore ne proces	1,511,558
Shpenzimet tjera humbjet nga Zhvlersimi i aktiveve	338,233
	<b>44,529,937</b>

### Palët e lidhura

Bashkia Shkoder zotëron direkt 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Veprimet dhe tepricat me Bashkine Shkoder, e cilat konsiderohet palë e lidhura, shfaqen në këtë shënim. Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë konsiderohet gjithashtu palë e lidhur.

### Transaksionet me palët e lidhura

	2020	2019
<b>Të ardhura</b>		
Te ardhura nga subvencionet	24,710,369	40,675,569
Transaksione me Bashkine Shkoder si agjent	3,350,993	3,348,952
	<b>28,061,362</b>	<b>44,024,521</b>
<b>Shpenzime</b>		
Taksa dhe tarifa vendore	0	0
	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kompensimi i personelit drejtues</b>		
Shpenzime personeli dhe kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,283,954	8,473,490
	<b>9,283,954</b>	<b>8,473,490</b>
<b>Te pagueshme</b>		
Bashkia Shkoder	533,478,752	472,238,945

### Kategorizimi i subjektit

Subjekti çilesohet si shoqeri me Interes Publik per shkakun e pronesisë, 100 % te aksioneve te kompanise zoterohen nga Bashkia Shkoder .





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

**Ndersa sipas treguesve të percaktuar në ligjin 25/2018 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"  
klasifikohet si me poshte :**

Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	290,444,277
Totali i bilancit	6,858,470,093
Nr mesatar Punonjesish	334
Nr. Punonjesisht Dhjetor 2020	310

**Klasifikohet si njesi ekonomike te medha .**

### 7.Fuqia Punetore

Nr mesatar i punonjesve per vitin 2020 eshte 334 , dhe ne dhjetor 2020 kane qene 310 punonjes te regjistruar sipas profesioneve me poshte :

Lloji I profesionit	Nr punonjesit
1112.01, Drejtor departamenti	4
1112.28, Përgjegjës sektori	6
1112.29, Përgjegjës zyre	1
1112.52, Këshilltar	2
1120.12, Drejtor i përgjithshëm në ndërmarrjeje	1
1213.02, Manaxher/Drejtor planifikimi strategjik	1
1321.06, Kryeinxhinier	1
2151.01, Inxhinier elektrik	1
2165.12, Topograf	1
2431.07, Specialist marketingu	2
2512.01, Informatikan	1
2522.01, Administrator i sistemeve kompjuterike	1
2611.03, Jurist	3
2621.01, Arkivist	1
2631.13, Ekonomist	7
3112.09, Teknik/inxhinieri civile (hidraulik)	1
3115.13, Teknik/inxhinieri mekanike (automjete)	2
3115.22, Teknik/përgjegjës sektori	11
3118.04, Teknik projektimi në inxhinieri	1
3119.04, Laborant uji	3
3123.05, Përgjegjës të tjerë në ndërtim	1
3133.10, Teknik i impiantit të ujërave të zeza	1
3133.17, Teknik i stacionit të pompimit të ujit	6
3133.18, Teknik trajtues uji	3
3136.17, Teknik nivel i mesëm	1
3333.04, Specialist i shërbimeve të punësimit	1
3352.01, Inspektor taksash	1
3359.05, Inspektor shërbimi civil	5
3513.02, Operator të tjerë rrjeti	9
4120.01, Sekretar	1
4132.03, Nëpunës regjistruar të dhënash në kompjuter	2
4211.03, Arkëtar qarkullim monetar	16
4214.03, Mbledhës fondesh për fatura të papaguara	5
4229.04, Nëpunës të tjerë të informimit për klientin	1
4311.07, Nëpunës revizioni	3
4321.01, Magazinier	4
4416.03, Nëpunës regjistrimi/personeli	1
5162.04, Punonjës shërbimi	3
5230.05, Arkëtar	1
5329.03, Sanitar	3
5414.02, Roje	4
7112.03, Murator për konstruksione	1





## Ujesjelles Kanalizime Qytet Sh.a.


Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë, nëse nuk specifikohet ndryshe)

7126.03, Hidraulik	27
7126.17, Punëtor për linja hidraulike	2
7212.09, Saldator	1
7223.11, Montues dhe punues në torno (tornitor)	1
7231.10, Mekanik për kamionë	1
7233.05, Mekanik tornitor	2
7411.01, Elektracist	8
8131.67, Pompist	73
8131.77, Punëtor i pajisjeve distiluese të parfumit	1
8322.01, Shofer	2
8322.03, Shofer furgoni	1
8322.07, Shofer veture	1
8332.08, Drejtues të makinave të pastrimit të kanaleve	3
8332.14, Shofer kamioni	1
8342.02, Drejtues ekskavatori	2
8342.03, Drejtues fadrome/fadromist	1
9129.03, Punëtor të pastrimit të lulishteve	1
9312.02, Punëtor krahu	20
9312.05, Punëtor krahu mirëmbajtjeje	3
9623.03, Faturist	12
9623.07, Lexues aparatesh matëse	5
9624.03, Pastrues pusetash ujëmbledhëse	4
9624.04, Zhbllokues kanalesh/pusetash	10
9629.01, Roje parkimi	2
9629.04, Punëtor gardërobe	2
	<b>310</b>

Ngjarjet mbas bilancit

- Në ngjarjet pas bilancit një ngjarje e rëndësishme e ndodhur në vitin 2020 është Covid-19. Opinioni jonë është që kompania jone nuk ka efekte të qënësishme te cilat mund te cenojne vijimesine e aktivitetit.



  
Geri Molla  
Hartuesi